Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2026/0566

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga U.D Kryetari i Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (LPP) në përbërje nga Vedat Poterqoi Kryetar, duke vendosur sipas ankesës së Operatorit Ekonomik (OE) "Pro Global" SH.P.K. kundër Njoftimin e kontratës ose me dokumentet e tenderit të Komuna Prizrenit në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK) lidhur me aktivitetin e prokurimit: "Mbushja dhe Servisimi I aparateve per zjarrefikes per objektet e shendetesise primare. (projekt 3 vjeqar)"me numër të prokurimit:**622-26-3081-2-2-1**, me 21/09/2026, mori:

Vendim

1. Aprovohet, si e pjesërisht e bazuar ankesa e OE"Pro Global" SH.P.K. me nr. 2026/0566, lidhur me aktivitetin e prokurimit "Mbushja dhe Servisimi I aparateve per zjarrefikes per objektet e shendetesise primare. (projekt 3 vjeqar)"me numër të prokurimit: **622-26-3081-2-2-1**, ndërsa (AK) - Komuna Prizrenit në cilësinë e Autoritetit Kontraktues.

2. Anulohet vendimi i AK lidhur me aktivitetin e prokurimit të përshkruar si në pikën 1 të këtij dispozitivi dhe lënda kthehet në ri-vlerësim.

3. Duke u bazuar në dispozitat e Rregullores së OSHP, kthehet tarifa të cilen OE ankues e ka bërë me rastin e paraqitjes së ankesës.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me 07.05.2026 Komuna Prizrenit në cilësinë e Autoritetit Kontraktues, ka publikuar Njoftimin për Kontratë lidhur me aktivitetin e prokurimit "Mbushja dhe Servisimi I aparateve per zjarrefikes per objektet e shendetesise primare. (projekt 3 vjeqar)" me numër të prokurimit:**622-**

26-3081-2-2-1.

Ky aktivitet i prokurimit është zhvilluar me procedurë e hapur me llojin e kontratës sherbime dhe me vlerë të parashikuar të kontratës 35,000.00 €.

Me27.07.2026 OE "Pro Global" SH.P.K. ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër vendimit të lartcekur të AK

OSHP ka pranuar ankesën nga OE "Pro Global" SH.P.K. me nr. 0566/2026 lidhur me aktivitetin e prokurimit "Mbushja dhe Servisimi I aparateve per zjarrefikes per objektet e shendetesise primare. (projekt 3 vjeqar)" me numër të prokurimit**:622-26-3081-2-2-1.**

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

OSHP ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë OSHP ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues "Pro Global" SH.P.K. janë parashtruar si në vijim:

Ne, si Operator Ekonomik pjesëmarrës në këtë procedurë të prokurimit, më datë 21.07.2026 kemi pranuar njoftimin mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues, përmes të cilit, në mënyrë të kundërligjshme, është propozuar për dhënie të kontratës një kompani e papërgjegjshme. Kjo procedurë e prokurimit, përgjatë gjithë procesit të saj, është karakterizuar me parregullsi serioze, si në vlerësimin e ofertave, ashtu edhe në rekomandimin e Operatorit Ekonomik të propozuar për kontratë.

Ne, si Operator Ekonomik i dëmtuar, në kuptim të nenit 108/A të LPP-së dhe brenda afatit të përcaktuar me ligj, kemi paraqitur kundërargumentet tona, të bazuara në dispozitat ligjore dhe në gjendjen faktike, duke kërkuar anulimin e vendimit/propozimit për dhënie të kontratës dhe kthimin e lëndës në rivlerësim. Megjithatë, Autoriteti Kontraktues ka lejuar që procedura të procedohet tutje, pavarësisht shkeljeve bazike ligjore të evidentuara.

Prandaj, në pajtim me nenin 109 të LPP-së, paraqesim këtë ankesë kundër vendimeve dhe veprimeve të Autoritetit Kontraktues.

PRETENDIMI ANKIMOR NR. 1

Pas shqyrtimit dhe analizimit të dokumentacionit të Operatorit Ekonomik të propozuar për dhënie të kontratës, rezulton se i njëjti ka dorëzuar ofertë të papërgjegjshme, si në aspektin administrativ, teknik, ashtu edhe në atë financiar.

Për këtë procedurë të prokurimit, sipas Dosjes së Tenderit dhe Procesverbalit të hapjes së ofertave, afati i fundit për dorëzimin, përkatësisht hapjen e ofertave, ka qenë data 09.06.2026.

Ndërsa, Operatori Ekonomik i rekomanduar për kontratë, në ofertën e tij, ka paraqitur Autorizimin nga Agjencia e Menaxhimit Emergjent (AME), me nr. 87/23, të datës 26.06.2023, me validitet deri më 26.06.2026.

Dosja e Tenderit parasheh një kontratë kornizë me kohëzgjatje prej 3 vitesh, përkatësisht deri në vitin 2029.

Kjo licencë/autorizim kishte afat vlefshmërie prej 3 vitesh dhe e njëjta ka skaduar më datë 26.06.2026. Si rrjedhojë, autorizimet e reja të lëshuara nga AME, me nr. 186/102, nr. 187/102 dhe nr. 190/102, janë lëshuar më datë 07.07.2026.

Vendimi i Autoritetit Kontraktues për dhënie të kontratës mban datën 21.07.2026.

Pra, nga data 26.06.2026, kur ka skaduar autorizimi/licenca e vjetër, deri më datë 07.07.2026, kur janë lëshuar autorizimet e reja, ekziston një shkëputje kohore prej 11 ditësh, gjatë së cilës Operatori Ekonomik nuk ka poseduar asnjë autorizim apo licencë të vlefshme nga AME për ushtrimin e veprimtarisë përkatëse.

Licencat e reja të datës 07.07.2026 nuk përmbajnë asnjë efekt retroaktiv. Rrjedhimisht, ato nuk përbëjnë vazhdimësi të licencës së vjetër, por paraqesin dokumente të reja dhe të drejta të reja juridike, të fituara vetëm më datë 07.07.2026.

Neni 72 i LPP-së lejon Autoritetin Kontraktues të kërkojë vetëm sqarime ose plotësime të dokumenteve ekzistuese, por nuk lejon ndryshimin material të ofertës apo krijimin e një gjendjeje të re kualifikuese pas afatit të dorëzimit të ofertave. Në këtë rast, licenca e re e datës 07.07.2026 nuk ka ekzistuar më datë 09.06.2026, përkatësisht në momentin e hapjes së ofertave.

Pranimi i një dokumenti të krijuar rreth një muaj pas hapjes publike të ofertave përbën ndryshim material të gjendjes së kualifikimit të Operatorit Ekonomik pas skadimit të afatit të ofertimit, gjë që është në kundërshtim me nenin 72 të LPP-së dhe me parimet e trajtimit të barabartë dhe transparencës në procedurat e prokurimit publik.

Objekti i kontratës është “Mbushja dhe servisimi i aparateve për zjarrfikës...”, me kohëzgjatje prej 3 vitesh. Posedimi i autorizimit/licencës valide nga AME përbën kërkesë konkrete kualifikuese, sipas Kërkesës 4, pikave 7.1 dhe 7.2 të Dosjes së Tenderit, ku shprehimisht është kërkuar:

Operatori Ekonomik duhet të jetë i licencuar nga Ministria përkatëse për ushtrimin e veprimtarisë për servisimin e aparateve për zjarrfikës.

Dëshmia:

Licencë valide nga organi përkatës për servisimin dhe rimbushjen e aparateve zjarrfikëse, të jetë me validitet; matjen e pikave të rrufepritësit dhe tokëzimit, të jetë me validitet; matjen e shtypjes së hidrantëve, të jetë me validitet.

Pra, AK-ja e ka kualifikuar si të përgjegjshme ofertën e OE-së, e cila në momentin e vlerësimit mbështetej në licencë të skaduar. Me këtë veprim, AK-ja ka shkelur parimin e mosdiskriminimit dhe të trajtimit të barabartë ndaj të gjithë ofertuesve të tjerë, të cilët kanë qenë të obliguar t’i përmbushin kërkesat e Dosjes së Tenderit brenda afatit të përcaktuar.

Prova 1 – Licenca e OE-së, datë 26.06.2023

Prova 2 – Licenca e OE-së, datë 07.07.2026

PRETENDIMI ANKIMOR NR. 2

Në Dosjen e Tenderit është kërkuar që Operatori Ekonomik të paraqesë dëshmi për realizimin e shërbimeve të ngjashme në vlerë minimale prej 52,500.00 €.

Në Dosjen e Tenderit, te Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale, pika 9.1 dhe 9.2, Kërkesa 1, Autoriteti Kontraktues ka kërkuar qartë:

Kërkesa 1. Projektet e ngjashme të natyrës së kontratës, të realizuara në tri vitet e shkuara (duke filluar nga koha e publikimit të këtij njoftimi), të vërtetuara nga OE, ku përfshihen titujt e projekteve, numri, data e kontraktimit dhe vlerat e tyre. Vlera minimale e të gjitha projekteve të natyrës së kontratës duhet të jetë jo më e vogël se 52,500.00 €. Në rast të krijimit të konsorciumit, OE bartës duhet të plotësojë minimum 60% të kapacitetit teknik dhe profesional të referencave të natyrës së kontratës.

Pavarësisht kërkesës së sipërpërshkruar, Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me kërkesat e Dosjes së Tenderit dhe dispozitat e Ligjit për Prokurimin Publik, duke e konsideruar si të përgjegjshme ofertën e Operatorit Ekonomik të propozuar për kontratë, përkundër faktit se ky operator nuk ka dëshmuar përmbushjen e kriterit të kërkuar për referenca profesionale.

Bazuar në dokumentacionin e dorëzuar dhe në sqarimet e ofruara, Operatori Ekonomik nuk ka arritur të dëshmojë referenca në vlerën e kërkuar dhe nuk ka plotësuar kriterin e përcaktuar në Dosjen e Tenderit.

Referencat e paraqitura janë:

- Komuna e Gjakovës, në vlerë prej 6,400.00 €, me përshkrimin: “Furnizim me mjete dhe pajisje kundër zjarrit”; dhe
- Korporata Energjetike e Kosovës (KEK), në vlerë prej 76,988.65 €, me përshkrimin: “FURNIZIM SISTEMI AUTOMATIK PËR SHUARJEN E ZJARRIT ME AEROSOL”.

Këto referenca nuk mund të konsiderohen si referenca të natyrës së ngjashme me shërbimet objekt i këtij aktiviteti të prokurimit, pasi objekti i kontratës, sipas Dosjes së Tenderit, është “Mbushja dhe servisimi i aparateve zjarrfikëse”, pra 100% shërbime, ndërsa furnizimi me pajisje paraqet natyrë tjetër të aktivitetit dhe nuk dëshmon përvojë në kryerjen e shërbimeve të kërkuara në Dosjen e Tenderit.

Për më tepër, edhe pas sqarimeve shtesë të kërkuara nga Autoriteti Kontraktues ndaj të njëjtit OE, ky i fundit nuk ka arritur të dëshmojë referenca të mjaftueshme në vlerën minimale prej 52,500.00 €, siç është kërkuar në Dosjen e Tenderit.

Pranimi i këtyre referencave si përvojë relevante përbën vlerësim të njëanshëm dhe favorizues ndaj kompanisë dhe cenon parimet bazike të prokurimit publik.

Fakti që Dosja e Tenderit ka përcaktuar objektin e kontratës, i cili ka të bëjë me mbushjen dhe servisimin e aparateve zjarrfikëse, nënkupton se përvoja e kërkuar duhet të lidhet me kryerjen e shërbimeve të njëjta ose të ngjashme, si:

- servisimi i aparateve zjarrfikëse;
- kontrollimi teknik;
- mbushja apo rimbushja e aparateve zjarrfikëse; dhe
- mirëmbajtja e aparateve kundër zjarrit.

Pra, Operatori Ekonomik i propozuar për dhënie të kontratës nuk ka arritur të dëshmojë se përmbush kërkesën e përcaktuar në Dosjen e Tenderit lidhur me përvojën profesionale dhe referencat e ngjashme.

Referenca me përshkrimin "Furnizimi me mjete dhe pajisje kundër zjarrit" nuk dëshmon asnjë ngjashmëri me realizimin e shërbimeve të mirëmbajtjes, kontrollit teknik, servisimit apo mbushjes së aparateve zjarrfikëse dhe, si e tillë, nuk mund të konsiderohet referencë e natyrës së ngjashme.

Përkundër mundësisë së dhënë për sqarime shtesë, OE nuk ka arritur të dëshmojë ekzistencën e referencave të kërkuara. Prandaj, Autoriteti Kontraktues ka bërë vlerësim të gabuar duke e konsideruar ofertën si të përgjegjshme, pasi kontrata e natyrës së shërbimeve nuk ka lidhje me kontratat e furnizimeve, të cilat komisioni për vlerësimin e ofertave dhe zyrtari përgjegjës i prokurimit i kanë trajtuar si referenca të pranueshme.

Me këto veprime, Autoriteti Kontraktues ka konsumuar shkelje të dispozitave të neneve 7, 59 dhe 69 të LPP-së.

OE i propozuar për kontratë, në letrën për sqarime shtesë, ka paraqitur dhe sqaruar referencat e mëposhtme, të cilat nuk janë të natyrës së ngjashme dhe nuk e arrijnë vlerën e kërkuar.

Prova 3 – Sqarimet shtesë nga OE i propozuar për kontratë

- Nuk është referencë e ngjashme.
- Nuk është referencë e ngjashme.

Ndërsa, referencat me përshkrimin:

"Furnizimi me mjete dhe pajisje kundër zjarrit" (Komuna e Gjakovës) dhe "FURNIZIM SISTEMI AUTOMATIK PËR SHUARJEN E ZJARRIT ME AEROSOL" (Korporata Energjetike e Kosovës),

NUK mund të konsiderohen referenca të ngjashme, sepse furnizimi paraqet shitje/dorëzim të mallrave dhe jo ofrim të shërbimeve.

Prova 4 – Kontrata për furnizim me mallra nga Komuna e Gjakovës

Prova 5 – Kontratat për furnizim dhe instalim me mallra nga KEK-u

RREGULLAT DHE UDHËZUESI OPERATIV PËR PROKURIMIN PUBLIK – Neni 10

PRETENDIMI ANKIMOR NR. 3

Nga analiza e ofertës financiare të Operatorit Ekonomik të propozuar për kontratë rezultojnë mospërputhje të dukshme në strukturën e çmimeve të ofruara për shërbimet e mbushjes dhe servisimit të aparateve kundër zjarrit dhe, si të tilla, do të duhej të trajtoheshin me kujdes të veçantë nga Autoriteti Kontraktues, duke marrë parasysh faktin se objekti i këtij aktiviteti të

prokurimit përfshin mbushjen dhe servisimin e aparateve kundër zjarrit, duke përfshirë mbushjen me pluhur dhe CO2, servisimin teknik dhe ndërrimin e pjesëve sipas nevojës, për një kontratë kornizë me kohëzgjatje prej 3 vitesh.

Operatori Ekonomik i propozuar për kontratë ka ofruar çmime që nuk paraqesin proporcionalitet me llojin, kapacitetin dhe kompleksitetin e aparateve, si më poshtë:

- Për aparatin zjarrfikës P6 kg (pluhur 6 kg) është ofruar çmimi 32.00 €;
- Për aparatin zjarrfikës P9 kg (pluhur 9 kg) është ofruar çmimi 34.00 €;
- Për aparatin zjarrfikës P25 kg (pluhur 25 kg) është ofruar çmimi 32.00 €;
- Për aparatin zjarrfikës P50 kg (pluhur 50 kg) është ofruar çmimi 32.00 €.

Pra, për aparatin zjarrfikës P50 kg (pluhur 50 kg) është ofruar çmim i njëjtë me atë të aparatit zjarrfikës P6 kg (pluhur 6 kg), çmim ky që ngre dyshime objektive për arsyeshmërinë ekonomike të ofertës, përkundër faktit se aparati P50 kg ka kapacitet dhe kosto të mirëmbajtjes dukshëm më të lartë se aparati P6 kg.

Po ashtu, për aparatin zjarrfikës P9 kg (pluhur 9 kg) është ofruar çmim më i lartë se për aparatin P50 kg, përkundër faktit se kapaciteti dhe kostoja e mbushjes dhe servisimit të aparatit P50 kg janë dukshëm më të larta.

Sipas faturës së paraqitur si provë, çmimi i pluhurit sillet rreth 2.00 €/kg, përfshirë blerjen, transportin, doganën dhe TVSH-në.

Prova 8 – Fatura e blerjes së pluhurit

Kostoja e pluhurit për aparatin zjarrfikës P6 kg është:

6 kg × 2.00 € = 12.00 €

Kostoja e pluhurit për aparatin zjarrfikës P50 kg është:

50 kg × 2.00 € = 100.00 €

Ndërsa, kostoja e servisimit të aparateve zjarrfikëse sillet rreth 6.00 €/copë.

Kjo nënkupton se kostoja e mbushjes me pluhur dhe servisimit për aparatin P6 kg do të ishte rreth:

12.00 € + 6.00 € = 18.00 €

Ndërsa, për aparatin P50 kg:

100.00 € + 6.00 € = 106.00 €

Në rast se është e nevojshme edhe ndërrimi i pjesëve, kostoja rritet edhe më shumë.

Sipas një kalkulimi tjetër, nëse çmimi i pluhurit sillet rreth 1.50 €/kg, kostoja e pluhurit për aparatin P6 kg do të ishte:

6 kg × 1.50 € = 9.00 €

Duke shtuar koston e servisimit prej rreth 6.00 €/copë, kostoja totale do të ishte rreth:

9.00 € + 6.00 € = 15.00 €

Pra, këto të dhëna paraqesin elemente objektive që ngrenë dyshime mbi arsyeshmërinë dhe strukturën e çmimeve të ofertës financiare të Operatorit Ekonomik të propozuar për kontratë.

E njëjta situatë paraqitet edhe në raport me aparatin P25 kg, ku struktura e çmimit krijon dyshime objektive mbi realitetin ekonomik të ofertës dhe mbi mënyrën e kalkulimit të kostove për realizimin e kontratës.

Duke marrë parasysh se bëhet fjalë për kontratë kornizë 3-vjeçare dhe se sasia e shërbimeve mund të ketë ndikim të drejtpërdrejtë në vlerën totale të kontratës, Autoriteti Kontraktues ka pasur obligim që të analizojë në mënyrë të hollësishme arsyeshmërinë e këtyre çmimeve dhe të kërkojë justifikim të plotë për kalkulimin e tyre, si dhe të zbatojë dispozitat e nenit 61 të LPP-së dhe dispozitat përkatëse të Rregullores për çmimet jo-normalisht të ulëta.

Ne, si Operator Ekonomik, jemi të bindur se Operatori Ekonomik i propozuar mund të ketë pasur informacione lidhur me sasitë reale të aparateve për secilin pozicion, duke i mundësuar atij të vendosë çmime jo proporcionale dhe potencialisht të favorshme në pozicione të caktuara.

Për këtë arsye, konsiderojmë se ekzistojnë elemente që duhet të jenë objekt i një analize të hollësishme nga Autoriteti Kontraktues dhe eksperti shqyrtues, në kuptim të nenit 61 të LPP-së – Tenderët me çmime jo-normalisht të ulëta.

Po ashtu, ne jemi në proces të deponimit të kërkesës për qasje, përkatësisht të njoftimit të Agjencisë për Informim dhe Privatësi, me qëllim të argumentimit dhe konfirmimit të pretendimeve tona lidhur me përfshirjen e grupit të caktuar në veprime të kundërligjshme.

Prova 6 – Çmimet e OE-së të propozuar për kontratë

PËRFUNDIM

Të gjitha këto prova dhe dëshmi të sipërpërmendura tregojnë dhe konfirmojnë se AK – Komuna e Prizrenit, Komisioni për Vlerësimin e Ofertave dhe zyrtari përgjegjës i prokurimit kanë bërë një vlerësim të kundërligjshëm të ofertës së Operatorit Ekonomik të propozuar për kontratë, duke tentuar të procedojnë me lidhjen e kontratës me një kompani, e cila, sipas pretendimeve dhe provave të paraqitura në këtë ankesë, nuk i ka përmbushur kërkesat e Dosjes së Tenderit.

Veprimet e tilla, sipas vlerësimit tonë, përbëjnë shkelje të dispozitave të LPP-së, të deklaratave nën betim dhe të parimeve të etikës profesionale në prokurimin publik.

Prandaj, Operatori Ekonomik ankues “Proglobal” SH.P.K. kërkon nga OSHP-ja që të autorizojë një ekspert shqyrtues profesional, me integritet dhe të paanshëm, i cili, bazuar në dispozitat e neneve 113 dhe 114 të LPP-së, do t’i trajtojë në mënyrë të plotë dhe objektive të gjitha pretendimet ankimore të ngritura nga Operatori Ekonomik ankues dhe të anashkaluara apo të paadresuara në mënyrë të duhur nga AK – Komuna e Prizrenit.

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Organi Shqyrtues i Prokurimit me datë 05/08/2026 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 0566/2026, ndërsa me datë 17/08/2026 është dorëzuar raporti i ekspertit shqyrtues me nr. 2026/0566 me rekomandimet si në

vijim: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si pjesërisht e bazuar, ndërsa vendimi i AK-së të mbetet në fuqi.

Paneli shqyrtues ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet për te vendosur mbi këtë lëndë pa seancë dëgjimore ne kuptim te nenit 24 paragrafi 1 te Rregullores së Punës së OSHP-së duke marr parasysh që pretendimet e palëve dhe parashtresat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritor lidhur me rastin.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave –

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova raportin e ekspertit, mendimet e palëve lidhur me raportin e ekspertit, parashtresat dhe dokumentet e ankuesit, shkresat dhe dokumentet e autoritetit kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Lidhur me pretendimet e OE "Pro Global" SH.P.K. eksperti shqyrtuese përmes raportit nr. 2026/0566 ka vlerësuar si në vijim:

OE ankues ka parashtruar ankesë pranë OSHP-së si palë e pakënaqur me vendimin e AK-së në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit, duke ngritur disa pretendime ankimore të cilat janë shqyrtuar nga eksperti shqyrtues dhe i njëjti sipas mendimit të tij ka dhënë përgjigje si më poshtë.

Pretendimi 1

"OE i rekomanduar është i papërgjegjshëm për arsye se edhe pse hapja e ofertave ka qenë me datë 09/06/2026, OE ka paraqitur Autorizimin nga Agjencia e Menaxhimit Emergjent me validitet deri më 26/06/2026, kurse kemi të bëjmë me kontratë kornizë 3 vjeçare, deri në vitin 2029. Kjo licencë kishte afat vlefshmërie prej 3 vitesh, ndërsa autorizimet e reja janë lëshuar me datë 07/07/2026, ndërsa vendimi për dhënie përmbanë datën 21/07/2026. Pra, nga data 26/06/2026 deri me datë 07/07/2026 ekziston shkëputje prej 11 ditësh kur OE i rekomanduar nuk ka poseduar asnjë autorizim apo licencë të vlefshme nga AME. Licencat e reja paraqesin dokument të rid he nuk përbëjnë asnjë vazhdimësi të licencës së vjetër."

Përgjigje

Eksperti shqyrtues sqaron që si kërkesë e dosjes së tenderit ka qenë që operatorët pjesëmarrës duhet të jenë të licencuar nga ministria përkatëse për ushtrimin e veprimtarisë për servisimin e aparateve për zjarrëfikës dhe si dëshmi të dorëzohet licenca valide nga organi përkatës me validitet.

OE i rekomanduar në ofertën e tij ka dorëzuar tre autorizimet e kërkuara sipas dosjes së tenderit të lëshuara nga Ministria e Punëve të Brendshme, përkatësisht Agjencia e Menaxhimit Emergjent të cilat janë lëshuar me 26/06/2023 dhe që kanë validitet prej tre (3) vitesh me mundësi vazhdimi.

Sqarojmë që data e fundit për dorëzimin e tenderëve ka qenë data 09/06/2026 kur është bërë edhe hapja e ofertave, që do të thotë që me rastin e dorëzimit të ofertave dhe hapjes së tyre të gjitha

autorizimet e dorëzuara kanë qenë valide. Tutje, sqarojmë që OE i rekomanduar me datë 13/07/2026 sipas sistemit e-prokurimi ka dorëzuar autorizimet e reja me validitet, ndërsa njoftimi mbi vendimin e AK-së është publikuar me datë 21/07/2026.

Eksperti sipas mendimit të tij sqaron që sipas rregullave të prokurimit publik, operatorët ekonomik duhet të kenë dokumentet e kërkuara në përputhje të plotë me kërkesat e dosjes me rastin e dorëzimit të ofertës dhe datës së fundit për dorëzimin e tyre. Në rastin konkret licencat e lëshuara nga MPB/AME gjatë ofertimit kanë pasur validitet edhe pas datës së hapjes së ofertave dhe kanë qenë në përputhje me kërkesat e dosjes me rastin e ofertimit. Posedimi i autorizimeve aktuale të cilat ende kanë validitet e pamundësojnë marrjen e autorizimeve të reja para kohës dhe para skadimit të autorizimeve aktuale, po ashtu vlerësojmë që marrja e autorizimeve të reja kërkon procedura të cilat po ashtu duhet ndjekur me qëllim të licencimit me certifikatat e reja.

Po ashtu, sqarojmë që askund në dosjen e tenderit nuk ka pasur kërkesë që licencat të cilat dorëzohen duhet të kenë validitet prej tre vitesh dhe sipas nenit 56.3 të Ligjit për Prokurimin Publik (LPP), një tenderues nuk mund të eleminohet në bazë të kërkesave të cilat nuk kanë qenë pjesë e njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit. Konsiderojmë që përderisa në ofertë janë dorëzuar autorizimet me validitet, dorëzimi i autorizimeve të reja me sqarime shtesë sipas mendimit tonë nuk përbënë dokumente të reja apo ndryshim material të ofertës siç është pretenduar nga OE ankues, andaj vlerësojmë që ky pretendim i ngritur nuk qëndron.

Pretendimi 2

"Në dosjen e tenderit janë kërkuar projekte të natyrës së ngjashme në tre vitet e fundit në vlerë prej 52,500.00 euro ku edhe pas kërkesave për sqarime nga AK, operatori nuk ka arritur të dëshmoj plotësimin e kriterit përmes referencave të dorëzuara. Pra, përderisa janë kërkuar projekte të natyrës së ngjashme këtu kemi të bëjmë me shërbime andaj kontratat për furnizime nuk mund të konsiderohen si referenca të natyrës së ngjashme. Sipas pikës 10 të udhëzuesit kur lista e kontratave nuk përmbush kërkesën minimale, refuzohet tenderi pa kërkuar informacione të mëtejshme."

Përgjigje

Eksperti shqyrtues sqaron që një nga kërkesat e dosjes së tenderit sa i përket kapacitetit teknik dhe profesional është edhe që operatorët ekonomik duhet të kenë të përfunduara projekte të ngjashme të natyrës së kontratës në tre vitet e shkuara në vlerë prej 52,500.00 euro dhe si dëshmi të ofrohen lista e projekteve si dhe referencat apo procesverbalet e pranimit përfundimtar të shërbimeve.

OE i rekomanduar në ofertën e tij ka ofruar listën e kontratave me një numër të madh kontratash, ndërsa dëshmitë përkatëse siç janë kërkuar në dosjen e tenderit janë dorëzuar vetëm për gjashtë prej tyre, ku disa janë edhe me autoritete private. AK me datë 30/06/2026 ka dorëzuar një letër standarde të kërkesës për sqarimin e tenderit ku ka kërkuar që të dorëzohen referencat e tjera për kontratat të cilat janë në listë si dhe dëshmi për pagesat bankare për dy referencat e dorëzuara me ofertë.

OE i rekomanduar me datë 03/07/2026 është përgjigjur në këtë kërkesë duke dorëzuar disa dëshmi të tjera shtesë duke përfshirë edhe dëshmitë e pagesave bankare për kompanitë private, shumica prej këtyre dëshmive nuk e përmubushin kriterin e dosjes për natyrën e ngjashme.

Sqarojmë që në asnjë pikë të dosjes së tenderit nuk është kërkuar që operatorët duhet të kenë të realizuara kontrata vetëm me autoritete publike, andaj edhe nëse sipas pretendimit të ngritur nuk marrim parasysh fare dy kontratat e lartëcekura atë me Komunën e Gjakovës dhe kontratën me KEK-un, prapseprapë sipas mendimit tonë OE i rekomanduar ka arritur të përmbushë kriterin e kontratave të ngjashme me shumën e kërkuar sa i përket kontratës së realizuar me kompani private për mirëmbajtje dhe servisim, pra pa llogaritur kontratat me kompanitë private të cilat janë vetëm me furnizim të aparateve të zjarrit apo ato që ende nuk kanë përfunduar që edhe sipas ekspertit shqyrtues këto kontrata nuk konsiderojmë që janë të natyrës së ngjashme dhe nuk janë në përputhje me kërkesat e DT-së.

Nga sqarimet e bëra më sipër vlerësojmë që ky pretendim i ngritur nga OE ankues është pjesërisht i bazuar.
Pretendimi 3"OE i rekomanduar ka ofruar ofertë financiare me çmime manipulative, përkatësisht për disa kategori janë ofruar çmime jo normalisht të ulëta, varësisht kostos së servisimit, pluhurit për aparatin zjarrëfikës OE i rekomanduar për aparatin P6kg, P9kg, P25kg dhe P50kg nuk ka ofruar çmime reale."PërgjigjeEksperti shqyrtues sqaron që në këtë aktivitet të prokurimit kanë ofertuar tre operatorë ekonomik, ku nëse analizojmë ofertat e tyre financiare për këtë aktivitet të prokurimit shihet se nuk ka dallime të mëdha mes ofertës më të lirë dhe asaj më të shtrenjtë, çfarë do të thotë se si ofertë e përgjithshme nuk shihet se është përmbushur kushti sipas nenit 41.3 të Rregullores për Prokurimin Publik (RRPP) për të cilësuar ofertën e OE i rekomanduar si ofertë jo-normalisht të ulët. Sa i përket pozicioneve të cekura me ankesë, vlerësojmë që është detyrë e Autoritetit Kontraktues që të kryejë hulumtimin e tregut në mënyrë që të jetë i informuar rreth çmimeve të përgjithshme të produkteve të cilat përfshihen në aktivitet, në mënyrë që të vlerësoj në mënyrë të duhur ofertat dhe që të veproj në përputhje me nenin 61 të Ligjit për Prokurimin Publik (LPP), por që vlerësimi i këtyre çmimeve mbetet në diskrecion të autoritetit.Sa i përket pretendimit se në pozicionet e caktuara janë ofruar çmime jo reale dhe si pasojë e këtyre çmimeve dyshohet se mund të bëhen manipulime, eksperti sqaron që sipas nenit 54.10 të RRPP-së pasqyrohet qartë që në rastin kur kemi të bëjmë me kontratën kornizë, mospërputhja e lejuar në këto raste për plus/minus tridhjetë përqind (30%) vlenë edhe për Lote dhe gjithashtu edhe për pozicion/artikull dhe në rast të arritjes së pragut të lejuar AK nuk mund të bëjë porosi të tjera për atë Lot apo pozicion/artikull që do të thotë që RRPP nuk lejon AK-në që të tejkaloj vlerën e lejuar sipas ligjit për pozicionet e caktuara. Nga sqarimet e bëra më sipër konsiderojmë që ky pretendim i ngritur nga ana e OE ankues është pjesërisht i bazuar.-

Gjetjet e Panelit Shqyrtues -

Bazuar në shkresat e kësaj lënde, Paneli konsideron se lidhur me çështjen në rastin konkret, nuk ka nevojë të konvokohet seanca dëgjimore me palë, në kuptim të nenit 24 paragrafit 1 të Rregullores së Punës së OSHP, duke marrë parasysh faktin që pretendimet e palëve dhe parashtresat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritor.

Paneli shqyrtues vlerëson se Raporti i ekspertit shqyrtues, i hartuar me kërkesën e OSHP lidhur me kontestin në ketë lëndë të aktivitetit të prokurimit publik, përmban elementet qenësore të një dokumenti të tillë sikurse parashihet me dispozitën e nenit 113 lidhur me nenin 114 të LPP, sipas të cilit kërkohet nga eksperti që ta shqyrtojë gjithë dokumentacionin e prokurimit, përfshirë të gjitha pretendimet ankimore dhe të pajisë Panelin dhe të gjitha palët në konteste me një vlerësim të pavarur dhe profesional mbi aktivitetin e prokurimit dhe vlefshmërinë e pretendimeve

ankimore.

Po ashtu, duhet theksuar faktin ligjor se raporti i ekspertizës nuk është detyrues për Panelin shqyrtues dhe se çdo raport i tillë vlerësohet dhe/ose analizohet në kontekstin e përgjithshëm të shkresave të lëndës, fakteve të pohuara dhe të provave eventuale e tjerë, duke e pasur parasysh natyrën e shkeljeve eventuale, rrjedhën, natyrën dhe qëllimin e aktivitetit të prokurimit, prandaj fakti se në cilat raste dhe për çfarë, Paneli e mbështetet apo jo, raportin e ekspertit dhe/ose ndonjë nga rekomandimet, i takon gjykimit të pavarur dhe profesional të tij/sajë, ashtu sikurse i adresohen këto përgjegjësi në kuptim të nenit 98, 99 lidhur me nenin 105 të Ligjit të Prokurimit Publik Paneli shqyrtues në mënyrë të pavarur dhe objektive, me ndërgjegje dhe kujdes profesional ka vlerësuar të gjitha provat e rastit.

Paneli Shqyrtues duke marre parasysh përshkrimin dhe faktet e lartpërmendura dhe pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të operatorit ekonomik ankues, analizës konkrete dhe dokumentacionit të lëndës, ankesën e operatorit ekonomik e sheh si pjesërisht të bazuara, dhe nuk e mbështet arsyeshmërin e ekspertit shqyrtues lidhur me pretendimeve ankimore të OE ankues, kundrejtë OE të rekomanduar për kontratë, me nr. 2 dhe 3 rreth projekteve të natyrës së ngjashme dhe pretendimin rreth ofertës finaciare

Duke u nisur nga kërkesat e dosjes së tenderit sa i përket kapacitetit teknik dhe profesional është edhe që operatorët ekonomik duhet të kenë të përfunduara projekte të ngjashme të natyrës së kontratës në tre vitet e shkuara në vlerë prej 52,500.00 euro dhe si dëshmi të ofrohen lista e projekteve si dhe referencat apo procesverbalet e pranimit përfundimtar të shërbimeve, është i sakt konstatimi i ekspertit se OE i rekomanduar në ofertën e tij ka ofruar listën e kontratave me një numër të madh kontratash, ndërsa dëshmitë përkatëse siç janë kërkuar në dosjen e tenderit janë dorëzuar vetëm për gjashtë prej tyre, ku disa janë edhe me autoritete private. Por paneli shqyrtues nuk e konsideron të mjaftueshme vetëm sqarimin në mes të AK dhe OE, pasi që futja e një numri të madh me kontrata të cilat nuk i përkasin kësaj natyre apo kontrata të cilat ende nuk ja përfunduar, apo kontrata të cilat janë përfunduar por dëshmit nuk i kanë sipas kërkesës së Dosjes së Tenderit, lë shumë dyshime për të cilat AK konform nenit 52. 7 duhet ti ndërmarrë të gjitha masat dhe të bëjë një verifikim edhe tek autoritet kontraktues për të cilat OE i rekomanduar ka deklaruar se kontratat i ka të përfunduar dhe të kërkoj dëshmi prej tyre sipas kërkesave të Dosjes së Tenderit.

Po ashtu edhe sa i përket pretendimit të ankuesit rreth ofertës financiare me çmime manipulative nga OE i rekomanduar se për disa kategori janë ofruar çmime jo normalisht të ulëta, varësisht kostos së servisimit, pluhurit për aparatin zjarrëfikës OE i rekomanduar për aparatin P6kg, P9kg, P25kg dhe P50kg nuk ka ofruar çmime reale." Paneli Shqyrtues nuk e mbështet në tërësi përgjigjen e Eksperti shqyrtues i cili sqaron që në këtë aktivitet të prokurimit kanë ofertuar tre operatorë ekonomik, ku nëse analizojmë ofertat e tyre financiare për këtë aktivitet të prokurimit shihet se nuk ka dallime të mëdha mes ofertës më të lirë dhe asaj më të shtrenjtë, çfarë do të thotë se si ofertë e përgjithshme nuk shihet se është përmbushur kushti sipas nenit 41.3 të Rregullores për Prokurimin Publik (RRPP) për të cilësuar ofertën e OE i rekomanduar si ofertë jo-normalisht të ulët. Sa i përket pozicioneve të cekura me ankesë, vlerësojmë që është detyrë e Autoritetit Kontraktues që të kryejë hulumtimin e tregut në mënyrë që të jetë i informuar rreth çmimeve të përgjithshme të produkteve të cilat përfshihen në aktivitet, në mënyrë që të vlerësoj në mënyrë të duhur ofertat dhe që të veproj në përputhje me nenin 61 të Ligjit për Prokurimin Publik (LPP), por që vlerësimi i këtyre çmimeve mbetet në diskrecion të autoritetit.Sa i përket pretendimit se në pozicionet e caktuara janë ofruar çmime jo reale dhe si pasojë e këtyre

çmimeve dyshohet se mund të bëhen manipulime, eksperti sqaron që sipas nenit 54.10 të RRPP-së pasqyrohet qartë që në rastin kur kemi të bëjmë me kontratën kornizë, mospërputhja e lejuar në këto raste për plus/minus tridhjetë përqind (30%) vlenë edhe për Lote dhe gjithashtu edhe për pozicion/artikull dhe në rast të arritjes së pragut të lejuar AK nuk mund të bëjë porosi të tjera për atë Lot apo pozicion/artikull që do të thotë që RRPP nuk lejon AK-në që të tejkaloj vlerën e lejuar sipas ligjit për pozicionet e caktuara. Nga sqarimet e bëra më sipër konsiderojmë që ky pretendim i ngritur nga ana e OE ankues është pjesërisht i bazuar. Paneli Shqyrtues konsideron se në këtë rast nuk mundet të merret për bazë vetëm dallimi i vlerës së përgjigjthshme të ofertave si dhe neni 41.3 i Rregullores për Prokurimin Publik (RRPP), për çmim jo normalisht të ulët përderisa ekziston neni 41.4 i po kësaj rregulloreje i cili citon se "*Kur tenderët duken të jenë jo-normalisht të ulët për arsye të tjera nga ato të parashikuara në paragrafin 41.3 të kësaj rregullore, autoritetet kontraktuese mund të vlerësojnë besueshmërinë e tenderëve të tille dhe rrjedhimisht të kërkojnë shpjegime në përputhje me paragrafët e mëposhtëm dhe nenin 61 të LPP-së*" si dhe neni 41.6 i Rregullores "N*ë rast se një tender (apo një pozicion i tenderit ku aplikohet çmimi i peshuar për njësi) duket të jetë jo normalisht i ulët, Autoriteti Kontraktues duhet të kërkoj me shkrim nga operatori ekonomik i cili ka dorëzuar tenderin ose pozicionin e tenderit që duket të jetë jo-normalisht i ultë sipas paragrafit 41.3 ose 41.4 të kësaj rregullore*" që do të thotë se edhe në rastet kur ka dallime të mëdha nëpër pozicione për çmime jo normalisht të ulta sikurse në këtë rast ndërmjet ofertave, AK duhet të bëjë një sqarim rreth tyre dhe të bëjë një hulumtim të tregut rreth kësaj dukurie e sidomos kur ka dyshime nga ndonjëra palë për çmime manipulative me qëllim të mbrojtjes së buxhetit.

Andaj, Paneli shqyrtues në mënyrë të pavarur dhe objektive, me ndërgjegje dhe kujdes profesional ka vlerësuar të gjitha provat e rastit. Në këtë mënyrë është gjetur se Autoriteti Kontraktues nuk ka vepruar në përputhje me dispozitat ligjore për prokurimin publik dhe kërkesat e Dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit "Mbushja dhe Servisimi I aparateve per zjarrefikes per objektet e shendetesise primare. (projekt 3 vjeqar)" me numër të prokurimit **622-26-3081-2-2-1**. Paneli shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe rekomandimet e ekspertit shqyrtues, ka gjetur se ankesa e Operatorit Ekonomik "Pro Global" SH.P.K. te aprovohet si pjesërisht e bazuar. dhe aktiviteti i prokurimit "Mbushja dhe Servisimi I aparateve per zjarrefikes per objektet e shendetesise primare. (projekt 3 vjeqar)" me numër të prokurimit**:622-26-3081-2-2-1, të kthehet në ri-vlerësim, konform konstatimeve të nxjerra në këtë vendim..**

Panelit Shqyrtueska vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Për pikat 1 dhe 2 të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 117 të LPP lidhur me nenin 29 dhe 31 paragrafin të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën 3 të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 31 paragrafin 4 dhe 6 të Rregullores së Punës së OSHP lidhur me nenin 118 të LPP.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

Vedat Poterqoi

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me padi mund t'i drejtohet Gjykatës Administrative në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm për anulim të vendimit në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit.

Vendimi t'i dorëzohet:

- AK - **KUVENDI KOMUNAL I PRIZRENIT**
- OE - **PROGLOBAL SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: